



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1600 Prot.

Tiranë, më datë 15.11.2021

VENDIM
Nr. 652, datë 12.11.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Vendimit Nr. 793, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kritereve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënie, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore”, pas shqyrtimit më parë të kërkesës në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.11.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së subjektit “AD-STAR” sh.p.k. për rinovimin e licencës si person juridik me Nr. 3, në veprimtari arkeologjike dhe veprimtari arkeologjike nënujore, me drejtues teknik z. Vangjel Dimo, në kategorinë:
 - a) A. Për veprimtarinë arkeologjike:
 - A1. Vëzhgim arkeologjik (Survey);
 - A2. Sondazhe arkeologjike;
 - A3. Gërmim Arkeologjik.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

KRYETAR
Elyza MARGARITI

